



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

Komuna e Novobërdës

Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KONTRATË PËR FURNIZIM

E Lidhur më 16.05.2019 në mes të:

KUVENDIT KOMUNAL NOVOBËRDË

e Përfaqësuar nga z. Fatos Ahmeti Menaxher i Prokurimit , në njërën anë; dhe

NTP Vlora me seli në Prishtinë

E përfaqësuar nga z. Visar Krasniqi , ne anën tjetër.

Furnizim me tonera për printer për nevojat e KK Novobërdëme numër Identifikues NB 654 2019 002 136

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë **Furnizim me tonera për printer për nevojat e KK Novobërdë**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me **DITEN E NENSHKRIMIT TE KONTRATES** dhe përfundon jo me gjatë se 10 dit Kalendarik

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 10 ditë nga data e marrjes së urdhëresës.

1.4 Vendi Selisja e KK Novobërdë në fshatin Bostan

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i menduar i kontratës do të jetë: 2,490.00€; [Dy mijë e katërqindë e nëntëdhjetë euro]

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

3.3 Menaxhimin e kësaj kontrate do ta bëjë Menaxheri që do të emërohet me vendim nga ana e kryetarit të komunës.

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj pagesat pasi të jetë bërë furnizim dhe pranimi teknik i furnizimit nga ana e komisioni ,komision ky që do të formohet nga Kryetari i komunës

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i **FURNIZIMIT** duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të jetë shkresa e OE e cila garanton cilësinë e furnizimit

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [të dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit,

t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *Furnizimit* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërën nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res-judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [specifiko gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip] në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Visar Krasniqi	Emri:	FATOS AHMEDI
Pozita:	Menaxher	Pozita:	Menaxher
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	16.05.2019 H.T.P	Data:	16.05.2019
Vula:		Vula:	




29	Fumizim me toner HP Laser jet Pro MF M130	copë	10	6.50	65.00
30	Fumizim me toner Laser jet Pro MFP M130fn	Copë	3	7.20	21.60
31	Fumizim me toner Rikon 1270 D 1515-1515f-mp161	Copë	2	7.50	15.00
32	Fumizim me toner Samsung ML - 2240 Series	Copë	4	16.00	64.00
33	Fumizim me toner Toshiba Studio 2505	Copë	2	8.00	16.00
34	Fumizim me toner Samsung model SCX -3400	Copë	1	10.00	10.00
35	Fumizim me toner Xerox Phaser 3100 MFP	Copë	1	15.00	15.00
36	Fumizim me toner RICOH-MP 2550	Copë	2	12.00	24.00
37	Fumizim me tone Lexmark X 264 dn	copë	5	15.00	75.00
38	Fumizim me toner HP Laser jet M 1132	Copë	5	7.00	35.00
39	Fumizim me toner SP1210N Nashuatec	Copë	5	8.00	40.00
40	Fumizim me toner Ricoh SP1200 s	copë	5	6.00	30.00
41	Fumizim me toner Canon F1513000	Copë	5	7.00	35.00
42	Fumizim me toner HP Laserjet 1536 dnf MFP	Copë	3	8.00	24.00
43	Fumizim me toner Canon C2020 L	Copë	2	8.00	16.00
44	Fumizim me toner Canon MF4370	Copë	3	9.00	27.00
45	Fumizim me toner HP Office Jet 7110	copë	1	9.40	9.40

Totali i
PËRGJITHSHËM

2490.00 €

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISE	N.T.P. "VLORA"
ADRESA E PLOTE	PR. BULEVARDI I DESHMOREVE" DARDANIA NR 292, 10.000/ PRISHTINE
PERFAQESUAR NGA:	
EMRI	VISAR KRASHUQI
POZITA	MENAXHER
NENSHKRIMI	
DATA	24.04.2019
VULA	





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo–Municipality of Novo Brdo



Artikulli	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi-€ (duke përfshirë të gjitha taksat etj)	Çmimi Total - €
1	Furnizim me toner Canon-LPB 3010	Copë	60	7.00	420.00
2	Furnizim me toner Samsung ML 1640	Copë	50	6.00	300.00
3	Furnizim me toner HP Laser jet proo m125a	Copë	5	7.00	35.00
4	Furnizim me toner HP Laser jet 1100	Copë	12	7.00	84.00
5	Furnizim me toner HP Laser jet 1200	Copë	16	6.00	96.00
6	Furnizim me toner Canon 4370 din	Copë	23	8.00	184.00
7	Furnizim me toner Canon LPB 2900	Copë	8	6.00	48.00
8	Furnizim me toner Canon Laser shot LPB 1120	Copë	4	7.00	28.00
9	Furnizim me toner Lexmark T 654	Copë	3	22.00	66.00
10	Furnizim me toner Canon laser shot 1120	Copë	4	8.00	32.00
11	Furnizim me toner Canon d 320	Copë	5	10.00	50.00
12	Furnizim me toner Canon MF 4550d	Copë	5	9.00	45.00
13	Furnizim me toner HP Laser jet 1320	Copë	1	15.00	15.00
14	Furnizim me toner Samsung mf 2010 komplet me drom	Copë	2	22.00	44.00
15	Furnizim me toner Canon iMF 4140	Copë	2	17.00	34.00
16	Furnizim me toner HP laser jet 1018	Copë	5	10.00	50.00
17	Furnizim me toner Canon 6512	Copë	3	12.00	36.00
18	Furnizim me toner HP laser jet P1005	Copë	3	13.00	39.00
19	Furnizim me toner Lexmark E 260din	Copë	2	25.00	50.00
20	Furnizim me toner HP laser jet pro mfp m127fn	Copë	10	8.00	80.00
21	Furnizim me toner HP Laser jet p2055	Copë	2	8.00	16.00
22	Furnizim me toner Hp Laser jet 1010	Copë	2	12.00	24.00
23	Furnizim me toner Canon pc-d3020	Copë	2	9.00	18.00
24	Furnizim me toner Olivetti 2010	Copë	2	12.00	24.00
25	Furnizim me toner HP Desingjet 110 puls Komplet	Copë	2	32.00	64.00
26	Furnizim me toner HP Laserjet Color 4650DN	Copë	2	8.00	16.00
27	Furnizim me toner Canon pc-d3020	Copë	3	10.00	30.00
28	Furnizim me toner Bizhup 211	Copë	2	20.00	40.00